

VENDIM
Nr.24, datë 11.1.2012

PËR PAGESËN E DETYRIMIT FINANCIAR INVESTITORËVE ITALIANË I.C.M.A. S.R.L.
DHE AGRI.BEN. S.A.S., ORTAKË NË ISH-SHOQËRINË E PËRBASHKËT “PRANVERA”
SHPK, SUKTH, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pagesën e detyrimit financiar investorëve italianë I.C.M.A. s.r.l. dhe AGRI.BEN. s.a.s., ortakë në ish-shoqërinë e përbashkët “Pranvera” sh.p.k., Sukth, Durrës, në vlerën 1 857 001 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e një) USD, vlerë për të cilën është rënë dakord sipas marrëveshjes së negocimit me këta investorë, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2012.

3. Procedura e pagesës dhe afati të jetë sipas marrëveshjes së negocimit të datës 7.10.2011, ndërmjet investorëve italianë I.C.M.A. s.r.l., dhe AGRI.BEN. s.a.s., dhe Republikës së Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha